



VENDIM

Nr. 185, Datë 23.11.2016

MBI KËRKESËN E TAP AG PËR APROVIMIN E “PROGRAMIT TË PËRPUTHSHMËRISË RREGULLATORE/REGULATORY COMPLIANCE PROGRAMME” TË RISHIKUAR, PARAQITUR NË BAZË TË OPINIONIT TË PËRBASHKËT PËRFUNDIMTAR /FINAL JOINT OPINION MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 12, DATË 14.02.2014

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 23.11.2016, në zbatim të Direktivës 2009/73/EC të Parlamentit European dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009 (Direktiva 73/09); Rregullores 715/2009/CE të Parlamentit European dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009; Ligjit nr.102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”; Vendimit të Komisionit European C (2013) 2949 të datës 16 Maj 2013; “Opinionit të Përbashkët Përfundimtar të Rregullatorëve të Energjisë mbi Aplikimin e TAP AG për Përfundimin (Autoriteti për Energjinë Elektrike dhe Gazin Itali (AEEGSI), Enti Rregullator i Energjisë Shqipëri (ERE) dhe Autoriteti Rregullator Greqi (RAE), në vijim Final Joint Opinion; Vendimit të Bordit nr. 12, datë 14.02.2014 “Për miratimin e Programit të Përputhshmërisë Rregullatore/Regulatory Compliance Programme”, paraqitur nga TAP AG në bazë të Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/Final Joint Opinion në kuadër të procedurës së përjashtimit të gazsjellësit TAP; Kërkesës së TAP AG të datës 17 Nëntor 2016, me numër reference të TAP LT-TAP-ERE-00018, për miratimin e “Programit të Përputhshmërisë Rregullatore/Regulatory Compliance Programme” të rishikuar,

Konstatoi se:

- ERE me vendimin nr. 12, datë 14.02.2014, ka miratuar Programin e Përputhshmërisë Rregullatore/Regulatory Compliance Programme, paraqitur nga TAP AG në bazë të Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/Final Joint Opinion në kuadër të procedurës së përjashtimit të gazsjellësit TAP.

- TAP AG ka dërguar në ERE në datën 17 Nëntor 2016, shkresën me numër reference të TAP LT-TAP-ERE-00018, për miratimin e “Programit të Përputhshmërisë Rregullatore/Regulatory Compliance Programme të rishikuar, si detyrim i seksioneve 4.5.1 dhe 4.5.2 të Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/ Final Joint Opinion (FJO).
- Drafti i rishikuar, i dorëzuar nga shoqëria TAP AG është diskutuar mes të tre rregullatorëve, AEEGSI, ERE dhe RAE, të cilët kanë rënë dakort për draftin final të Programit të Përputhshmërisë Rregullatore/Regulatory Compliance Programme.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të miratojë Programin e Përputhshmërisë Rregullatore/Regulatory Compliance Programme të rishikuar (bashkëlidhur ketij vendimi).
2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë TAP AG, Rregullatorin Italian (AEEGSI), Rregullatorin Grek (RAE) dhe MEI, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet brenda 30 ditëve në Gjykatën Administrative.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI